

NJOFTIM PËR SHITJE PËRMES ANKANDIT TË TRETË PUBLIK

Banka për Biznes njofton të gjitha subjektet e interesuara se Përmbaruesi Privat z. Gjakë Radi me datë 26.06.2015, ka nxjerrë Konkluzionin mbi shitjen e patundshmërisë së debitorit Kompania "Sejfullahu" Sh.p.k, me pronarë z. Musli Sejfullahu.

Në bazë të Konkluzionit P.nr.212/2015 të datës 26.06.2015 është caktuar shitja publike e patundshmërisë edhe atë:

- Patundshmërisë që gjendet në Krushë të Madhe-Rahovec - kultura shtëpi-oborr-arë, në sipërfaqe prej 0.14.42 ha $\frac{1}{2}$, vendi i quajtur Ksolla, parcela kadastrale nr.2020/1, 2020/2 dhe 2020/3, fleta poseduese nr.71513005, Zona Kadastrale Krusha e Madhe.

Patundshmëria e sipërshënuara është vlerësuar në shumë prej 220,000.00 €.

- Ngastra kadastrale nr.184 me kulturë arë e klasit 2, 3 dhe 6, në sipërfaqe prej 0.73.21 ha, Zona Kadastrale Krushë e Madhe.

Patundshmëria e sipërshënuar është vlerësuar në shumë prej 131,778.00 €.

Në seancën e ankandit të tretë publik të shitjes, patundshmëritë nuk mund të shitet me çmimin me të ulët se 1/3 (një e treta), e vlerës së përcaktuar të patundshmërive të lëna në hipotekë.

Vendi i shitjes: **Zyra e Përmbaruesit Gjakë Radi në adresën Rr. "Nënë Tereza", p.n. Gjakovë;**

Data e shitjes: **22.07.2015**, e mërkurë;

Koha e shitjes **14:00 h;**

Të drejtë pjesëmarrje në ankand kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat të cilët ofertojnë duhet të deponojnë në llogarinë e posaçme të Përmbaruesit shumën prej 10 % të vlerës së patundshmërisë por jo më shumë se 5,000 € (pesë mijë euro) para se të filloi seanca.

Depozita do t'iu kthehet ofertuesve të pasuksesshëm menjëherë pas ankandit.